

## POLITIKA NDËSHKIMORE NDAJ VEPRAVE PENALE KUNDËR EKONOMISË NË KOSOVË GJATË PERIUDHËS 2015-2019

### **Abstrakt**

Së fundmi, veprat penale kundër ekonomisë janë në rritje të vazhdueshme. Prandaj me të drejtë ky grup i veprave penale është paraparë në legjislacionin e të gjitha vendeve demokratike që kanë për synim sundimin e rendit dhe ligjit. Veprat penale kundër ekonomisë padyshim shkaktojnë pasoja të shumta për ekonominë, sistemin ekonomik dhe financiar të secilit shtet, qoftë ai edhe me ekonomi të zhvilluar dhe me sundim të rendit dhe ligjit. Krizat dhe pasojat që sjell ky grup i veprave penale kanë ndikim të fuqishëm në paraqitjen e kriminalitetit ekonomik dhe kriminit në përgjithësi. Andaj këto vepra penale duhet të luftohen dhe parandalohen nga ana e shtetit me masa preventive adekuate dhe akte ligjore përkatëse.

Shteti me anë të politikës ndëshkimore lufton dhe parandalon kriminalitetin në përgjithësi e në veçanti edhe kriminalitetin ekonomik. Kjo politikë ndëshkimore nënkupton procesin e inkriminimit të sjelljeve të caktuara kriminale, zbulimin e veprave penale dhe kryerësve të tyre, ndjekjen e veprave penale dhe kryerësve të tyre, shqiptimin e dënimeve dhe sanksioneve të tjera penale ndaj kryerësve të veprave penale si dhe ekzekutimin e dënimeve dhe sanksioneve të tjera penale.

Në këtë mënyrë, kjo politikë përfshin sistemin e funksionimit të legjislacionit penal si dhe organizimin dhe funksionimin e organeve të drejtësisë, siç janë: policia, prokuroritë, institucionet për ekzekutimin e dënimeve etj., në drejtim të aplikimit të sanksioneve penale dhe ekzekutimit të tyre. Kjo bën të mundur edhe realizimin e qëllimeve të legjislacionit penal dhe të judikaturës penale në përgjithësi.

Studimi i politikës ndëshkimore ndaj veprave penale kundër ekonomisë është me rëndësi të madhe ngase veprat penale kundër ekonomisë paraqesin grupin e atyre veprave që kanë pësuar rritje gjatë viteve të fundit, e janë prezente në masë të madhe edhe në Kosovë. Këto vepra penale gjatë këtyre viteve kanë manifestuar pasoja të rënda për shoqërinë dhe ekonominë e vendit. Andaj me të drejtë edhe duhet të studiohet politika ndëshkimore ndaj këtyre veprave, për të kuptuar se sa është adekuate, sa po ndikon dhe sa do të duhej të ndikonte në luftimin dhe parandalimin e kryerjes së këtij lloji të kriminalitetit. Po ashtu të jetë në pajtim me qëllimet e saj, të cilat kanë të bëjnë me

mbrojtjen e vlerave të shoqërisë dhe mbrojtjen e vlerave ekonomike në një shtet ,si dhe ndëshkimin e riedukimin e suksesshëm të kryerësve të këtyre veprave penale në mënyrë që të mos përsëriten sjelljet e tyre kriminale të mëparshme.

**Fjalët kyçe :** veprat penale kundër ekonomisë,kriminaliteti ekonomik,sistemi ekonomik,politika ndëshkimore,legjislacioni penal,zbulimi i kryerësve,ndjekja e kryerësve,shqiptimi i sanksioneve penale.

**Mentori:** Prof. Dr. Rexhep Gashi

**Kandidatja:** Fatbardha Bilalli